



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**THIRRJE PËR APLIKIM**

Autoriteti i Mediave Audiovizive në mbështetje të Ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “ Kodi i Punës, i ndryshuar, kërkon të kontraktojë për shërbim Call Center, katër punonjës për vijëmesinë e procesit të informimit të publikut për procesin e digjitalizimit.

**TERMAT E REFERENCËS**

**Objektivi i punës**

Të kontribuojë për vijëmesinë normale të informimit të publikut për transmetimet audiovizive nga përdoruesit pas kalimit në transmetimet numerike.

**Detyrat kryesore:**

\_ - Të përgjigjet telefonatave të publikut lidhur me informacionin e kërkuar për procesin e digjitalizimit, problemet, paqartësitë, ndryshimet, apo veprimet që duhet të kryhen nga teleshikuesit me dekoderin dhe televizorin për marrjen e transmetimeve digjitale.

Autoriteti do ti sigurojë punonjësve të Call Center të gjithë informacionin e nevojshëm mbi procesin e digjitalizimit për përmbushjen e detyrave të mësipërme.

**Kritere të veçanta:**

- Aftësi ndërpersonale dhe komunikuese
- Aftësi për të punuar në grup
- Të zotërojnë diplomë të nivelit Bachelor
- Sensibilitet në marrëdhëniet ndërpersonale
- Të ketë minimalisht një vit eksperiencë në punë

**Kritere të përgjithshme:**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të zotërojnë gjuhën shqipe , të shkruar dhe të folur
- Të jetë në kushtë shëndetësore për të ushtruar detyrën
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kryerjen e një kundërvatje penale.

Kandidatët duhet të depozitojnë pranë Autoritetit të mediave Audioviziv dokumentet si më poshtë:

- Jetëshkrimin;
- Fotokopje e noterizuar të diplomës bachelor
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore
- Fotokopje të kartës së identitetit
- Fotokopje të librezës së punës ku të vërtetohet eksperiencia në punë

**APLIKIMET MBYLLEN ME DATË. 30.12.2016**



AUTORITETI I  
MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE

Rruga "AbdiToptani", 1001, Tiranë | [ëëë.ama.gov.al](http://ëëë.ama.gov.al)  
Tel. +355 4 2233370 | Email. [info@ama.gov.al](mailto:info@ama.gov.al)